

Nuk do të ketë pagesë të vecantë për sigurimin dhe vendosjen e të treja tabelave lajmeruese, duke qenë se kostoja e tyre është e përfshirë në Preventiv nga Kontraktori.

### **Urdheri me shkrim**

"Urdher me shkrim" do të thotë çdo dokument apo leter e firmosur nga Supervizori dhe e dërguar me postë apo që i jepet Kontraktorit dhe ku Kontraktori i jepin instruksione, udhëzime apo drejtime në lidhje me Kontraten.

Pavaresisht në përdoren fjalet: miratuar, drejtuar, autorizuar, kerkuar, lejuar, urdheruar, treguar, përfshirë edhe emra, folje, mbiemra dhe ndajfolje të së njëjtes rëndësi, do të kuptohet që shprehin miratimin, drejtimin, udhëzimin, autorizimin, kërkesën, lejen, urdherin, instruksionin etj. të Supervizorit.

### **Karakteristikat e Materialeve**

Materialet që do të përdoren gjatë punimeve duhet të përmbahen standarteve dhe rregullave ndërkombëtare për materialet e punimeve civile. Në rast se nuk ka kërkesa specifike materialet duhet të jenë të cilësive më të mira që ekzistojnë në treg dhe që përdoren për qëllimin e caktuar. Megjithatë, materialet duhet të aprovohen nga Supervizori përpara se të vihen në përdorim.

### **Burimet e materialeve**

Materialet do të sigurohen nga ato burime ose fabrika që konsiderohen të përshtatshme nga Kontraktori, duke u siguruar se zbatohen rregullat e më sipërme.

Në rast se Supervizori refuzon materialet si të papërshtatshme për përdorim, atëherë, Kontraktori duhet të zëvendësojë ato me materiale të tjera që i korrespondojnë karakteristikave të dëshiruara; materialet e refuzuara duhet të hiqen nga vendi i ndërtimit nën kujdesin dhe me shpenzimet e Kontraktorit.

Megjithatë, aprovimi i materialeve nga Supervizori, Kontraktori mbetet përgjegjës i plotë i punës së specialisteve si edhe të vete materialeve.

## 1. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITË

### 1.1 Hidroizolim me dy shtresa astar me bazë çimento. Përgatitur nga dy komponentë A+B

Hidroizolimi i elementeve të themelit do të realizohet me dy shtresa astar me bazë çimento, të përgatitur nga dy komponentë A+B, të aplikuara mbi sipërfaqe të pastruara dhe të niveluara. Mbi këtë shtresë do të aplikohet hidroizolim me emulsion bitumi dhe një shtresë katrama, duke siguruar mbivendosje të shtresave rreth 12–15 cm për garantimin e vazhdimësisë së izolimit. Në zonën e kontaktit midis pllakës së themelit dhe mureve vertikale, shtresa hidroizoluese do të ngrihet në mur me minimum 20–30 cm, për të parandaluar depërtimin e lagështisë nga toka dhe për të siguruar izolim të plotë të nyjeve konstruktive. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek ndërtesa e “Bibliotekës” dhe “Qendrës së kreativitetit”, sipas detajeve të projektit.

### 1.2 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama

Hidroizolimi i sipërfaqeve do të bëhet në lidhja që bëhet e objektit të “Bibliotekës me “Galerinë e Artit” objektin e në kontakt me tokën do të realizohet me emulsion bitumi dhe 1 shtresë katrama, të aplikuara në mënyrë të njëtrajtshme mbi sipërfaqe të përgatitura paraprakisht. Shtresat do të vendosen me mbivendosje rreth 12–15 cm për të shmangur depërtimin e ujit. Në pjesët perimetrale, hidroizolimi do të zgjatet në mënyrë vertikale mbi muret e themelit, duke krijuar një barrierë të vazhdueshme kundër lagështisë dhe ujërave nëntokësore. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek ndërtesa e “Bibliotekës” dhe “Qendrës së kreativitetit”, sipas detajeve të projektit.

### 1.3 Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat $\Phi$ 100

Janë për shkarkimin e ujrave të çative. Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të çative përgatiten me llamarinë xingat, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 100 mm. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili” në një zonë në të cilën nuk ka ulluk por është e nevojshme sipas detajeve të projektit.

### 1.4 Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat 33 cm

Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale prodhohen me material llamarinë xingat. Ulluku me llamarinë xingat me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili” sipas detajeve të projektit.

## 2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI

### 2.1 Suva e zakonshme fasade mur guri ~ 8m

Sprucim me llaç çimentoje të lëngët, për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m<sup>2</sup>: rërë e larë 0,005 m<sup>3</sup>; llaç gëlqereje m- 1: 2, 0.03 m<sup>3</sup>; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin. Suvatimi realizohet në disa shtresa:

- shtresa e parë (spërkatje)
- shtresa mbushëse
- shtresa përfundimtare

Sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë e rrafshët dhe pa deformime. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në murin rrethues të ndërtesës.

### 2.2 Veshje fasade me pllaka guri

Veshje e fasadës me pllaka guri realizohet me llaç çimentoje, ngjitës special për gurë natyralë ose llaç fleksibël në varësi të tipit të murit i cili në rastin e Bibliotekës do të shërbejnë si plintuese) do të vishet pjesa e murit prej ferizoli e cila bashkohet me shkallët të cilat ndodjnë të dy objektet. Përzihet sipas udhëzimeve të prodhuesit për të arritur konsistencën e dëshiruar. Veshja fillon nga poshtë për të garantuar stabilitet. Ngjitësi vendoset si në mur ashtu edhe në pjesën e pasme të gurit. Shtypet lehtë për të siguruar ngjitje të mire, përdoren distancues për të ruajtur hapësirat e barabarta midis gurëve. Prerja e gurëve bëhet me makineri prerëse për të përshtatur format e gurit me qoshet ose dritaret. Përdoret llaç fugimi ose llaç çimentoje për të mbushur hapësirat midis gurëve. Pasi llaçi të jetë tharë pak, sipërfaqja pastrohet me sfungjer të lagur për hequr mbetjet. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek ndërtesa e “Qendrës së kreativitetit” sipas detajeve të projektit.

### 2.3 Plintuse grez h = 10 cm

Plintuset prej grezi me lartësi 10 cm do të realizohen përgjatë perimetrit të mureve të ambienteve të brendshme të katit përdhe në objekti tek muzeu i fotografisë “Gjon Mili”, me funksion mbrojtës dhe estetik. Ato shërbejnë për të mbrojtur pjesën e poshtme të murit nga goditjet mekanike, lagështira dhe ndotjet, si dhe për të krijuar një lidhje vizuale të rregullt midis dyshemesë dhe murit.

Para vendosjes së plintuseve, sipërfaqja e murit dhe baza e kontaktit do të pastrohen dhe nivelohen në mënyrë që të sigurohet aderencë optimale. Vendosja do të kryhet me ngjitës të posaçëm për materiale qeramike, duke respektuar vijëzimin horizontal dhe drejtimin linear të tyre. Prerjet në qoshe dhe bashkimet do të realizohen me kujdes për të garantuar përfundim estetik dhe të njëtrajtshëm.

Fugat ndërmjet elementëve do të mbushen me material fugatues cilësor, rezistent ndaj lagështirës dhe konsumit, duke siguruar qëndrueshmëri dhe mirëmbajtje të lehtë në kohë. Pas përfundimit të punimeve, sipërfaqja do të pastrohet nga mbetjet e materialeve, duke lënë një përfundim të pastër dhe profesional. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në katin e parë, në ambientin e zyrës dhe dhomës së serverit.

### 3. PUNIME SHITESASH

#### 3.1 Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Pështetja/ngarkesa e sipërfaqes
- Koeficienti i rrëshqitjes

Tabelat e mëposhtme përshkruajnë disa prej këtyre kriterëve.

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

I	$E < 3 \%$
II a	$3 \% < E < 6$
II b	$6 \% < E < 10$
III	$E > 10 \%$

Klasat e kërkesave/ngarkimit		
Klasa	Ngarkesa	Zona e përdorimit, psh
I	Shumë e	Dhoma fjetëse, Banjo
II	E lehtë	Dhoma banuese përveç kuzhinës dhe paradhomës

III	E mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	Rëndë	Zyra, paradhoma, dyqane
V	Shumë e	Gastronomi, ndërtesa publike

Për këtë sipërfaqe duhet që pllakat të jenë të Klasës V, me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje. Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të Klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit < 3 %. Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me certifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në katin e pare, në ambientin e zyrës dhe dhomës së serverit.

## 4. PUNIME BOJATISJE

### 4.1 Bojë hidroplastike cilësi e lartë

Proçesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve kalon nëpër tre faza si më poshtë:

Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet:

- Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e bojës së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje.
- Përpara fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Paralyerja e sipërfaqes së pastruar:

- Në fillim të proçesit të lyerjes, bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqeren të holluar (Astari). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg gëlqere me një litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.
- Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m<sup>2</sup> sipërfaqe.

Lyerja me bojë hidromat e sipërfaqes:

- Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngët e cila është e paketuar në kuti 5 – 15 litërshe. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.
- Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat i holluar duhet të përdoret për 2.7 – 3 m<sup>2</sup> sipërfaqe. Kjo normë varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji i bojës së mëparshme.

- Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lyerje.
- Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.
- Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (Astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.
- Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m<sup>2</sup> sipërfaqe. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë si më poshtë:
- Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngshëm me ujë. Lëngu I bojës hollohet me ujë në masën 20 – 30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigment derisa të merret ngjyra e dëshiruar.
- Bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar në 2.7 – 3 m<sup>2</sup> sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyer).

Kjo ndërhyrje do të kryhet tek ndërtesa e “Bibliotekës” dhe “Qendrës së kreativitetit” sipas detajeve të projektit.

#### 4.2 Bojë hidroplastike

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngët e cila është e paketuar në kuti 5 - 15 litërshe. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30%. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat i holluar duhet të përdoret për 2.7 – 3 m<sup>2</sup> sipërfaqe. Kjo normë varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji i bojës së mëparshme. Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lyerje. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m<sup>2</sup> sipërfaqe. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë. Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngshëm me ujë. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20 - 30%. Kësaj përzierje i hidhet pigment derisa të merret ngjyra e dëshiruar. Bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar në 2.7 - 3 m<sup>2</sup> sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së

sipërfaqes së lyer). Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në murin rrethues të ndërtesës si dhe në murin anësor të shkallëve që të çojnë në katin nëntokë.

## **5. PUNIME DHEU**

### **5.1 Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km**

Materialet që do hiqen nga objekti apo akumulimi i inerteve, dherat e lëvizura, do të hiqen në mënyrë manuale me lopatë dhe largimi i tyre nga kantieri deri te mjete i transportit do të bëhet me karro dore. Dherat e pastruar si dhe materialet inerte do të largohen nga kantieri me automjet. Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 5 km larg nga kantieri.

## **6. ANALIZA JASHTË LISTE**

### **6.1 Prishje sipërfaqe me rezinë ekzistuese**

Prishja e sipërfaqes ekzistuese me rezinë do të realizohet me qëllim eliminimin e plotë të shtresës së vjetër dhe përgatitjen e bazës për aplikimin e shtresave të reja. Procesi do të kryhet me mjete mekanike të përshtatshme, si freza, dalta elektrike apo pajisje të tjera profesionale, të cilat sigurojnë heqjen efektive të rezinës pa dëmtuar strukturën mbajtëse poshtë saj.

Gjatë punimeve do të tregohet kujdes për të ruajtur integritetin e shtresës bazë, duke shmangur goditjet e tepërta apo dëmtimet që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e mëtejshme të dyshemesë. Materiali i prishur do të mbledhet, ngarkohet dhe transportohet në vendet e përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte, në përputhje me rregullat në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Pas përfundimit të prishjes, sipërfaqja do të pastrohet plotësisht nga mbetjet, pluhurat dhe materialet e lirshme, duke krijuar një bazë të qëndrueshme, të pastër dhe të përshtatshme për ndërhyrjet pasuese. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në katin e parë, në hapësirën e ekspozimit.

### **6.2 F.V Dysheme rezinë transparente mbi struktura të thata**

Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë me rezinë mbi struktura të thata do të realizohet në përputhje me kërkesat teknike dhe specifikimet e materialeve përkatëse, me qëllim krijimin e një sipërfaqeje estetike, të qëndrueshme dhe me rezistencë të lartë ndaj konsumit ngjyra e rezinës do të jetë si ajo ekzistuese kodi i saj do të përcaktohet gjatë kryerjes së punimeve.

Fillimisht, struktura mbajtëse (bazë e thatë) do të kontrollohet për qëndrueshmëri, rrafshësi dhe pastërti. Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, pa pluhur, yndyrna apo materiale të lirshme që mund të ndikojnë në aderencën e rezinës. Në rast nevojë, do të kryhen ndërhyrje për nivelim dhe përforsim të bazës.

Aplikimi i sistemit të rezinës transparente do të realizohet në disa faza, duke filluar me shtresën e parë (primer) për rritjen e aderencës, e ndjekur nga shtresat kryesore të rezinës, të cilat do të shpërndahen në mënyrë uniforme me mjete profesionale. Trashësia dhe numri i shtresave do të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe funksionale të projektit.

Gjatë aplikimit do të respektohen kushtet optimale të temperaturës dhe lagështisë, si dhe kohët e tharjes ndërmjet shtresave, për të garantuar një përfundim pa defekte, pa flluska ajri dhe me transparencë të lartë. Në përfundim, do të sigurohet një sipërfaqe e njëtrajtshme, me rezistencë të mirë mekanike dhe kimike, e përshtatshme për përdorim afatgjatë dhe me kërkesa minimale mirëmbajtjeje. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në katin e parë, në hapësirën e ekspozimit.

### **6.3 Heqje + Vendosje kase druri vitrine**

Heqja dhe vendosja e kasës së drurit të vitrinës do të realizohet me kujdes të veçantë, me qëllim ruajtjen e integritetit të elementëve ekzistues dhe rikthimin e funksionalitetit të plotë të saj. Fillimisht do të kryhet çmontimi i kasës ekzistuese, duke përdorur mjete të përshtatshme manuale dhe mekanike, në mënyrë që të shmangen dëmtimet e panevojshme si në vetë kasën, ashtu edhe në strukturën përreth (dyshemenë).

Gjatë procesit të heqjes do të evidentohen dhe seleksionohen elementët që mund të ripërdoren, ndërsa pjesët e dëmtuara do të zëvendësohen sipas nevojës. Pas përfundimit të çmontimit, do të kryhen punimet e nevojshme për përgatitjen e vendit të montimit, duke përfshirë pastrimin, nivelimin dhe rregullimin e sipërfaqeve mbajtëse.

Vendosja e kasës së drurit do të realizohet duke respektuar përmasat ekzistuese dhe drejtimit horizontale e vertikale, duke përdorur elementë fiksues të përshtatshëm (vida, kunja, shkumë montimi, etj.) për të garantuar stabilitet dhe qëndrueshmëri. Në përfundim, do të kryhen rregullimet përfundimtare, përfshirë mbylljen e boshllëqeve, sistemimin e nyjeve dhe trajtimin sipërfaqësor, duke siguruar një përfundim estetik dhe funksional në përputhje me kërkesat e projektit. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në katin e parë, në hapësirën e ekspozimit.

### **6.4 Suva fino muri shkallët anësore**

Suva fino do të aplikohet si shtresë përfundimtare mbi sipërfaqet e suvuara më parë, me qëllim arritjen e një përfundimi të lëmuar, të njëtrajtshëm dhe të gatshëm për bojatisje ose trajtime të tjera dekorative. Para aplikimit, sipërfaqja bazë do të kontrollohet për pastërti, qëndrueshmëri dhe lagështi të përshtatshme, duke eliminuar pluhurat dhe papastërtitë që mund të ndikojnë në aderencën e materialit.

Materiali fino, me bazë çimentoje ose gipsi sipas kushteve të përdorimit, do të përgatitet në përputhje me udhëzimet teknike dhe do të aplikohet në shtresa të holla me mjete

profesionale, duke siguruar shpërndarje uniforme në të gjithë sipërfaqen. Gjatë aplikimit do të kryhet nivelimi dhe lëmimi i vazhdueshëm për të eliminuar parregullsitë dhe për të arritur rrafshësi maksimale.

Pas tharjes, sipërfaqja do të kontrollohet dhe, nëse është e nevojshme, do të kryhen ndërhyrje të lehta për përmirësimin e cilësisë së përfundimit. Rezultati final do të jetë një sipërfaqe e lëmuar, pa defekte dhe e përshtatshme për aplikimin e shtresave përfundimtare, duke garantuar cilësi estetike dhe qëndrueshmëri në kohë. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, në murin anësor të shkallëve që të çojnë në katin nëntokë.

### **6.5 Prishje shtrese + vendosje pllaka guri**

Punimet objekt të këtij projekti konsistojnë në prishjen e shtresave ekzistuese të shjallëve në ambientet e jashtme ndërmjet bibliotekes dhe galerisë së Artit shtrimin e shtresës së izolimit dhe me pas rivendosjen e pllakave të gurit sipas standardeve të ndërtimit. Procesi fillon me heqjen e kontrolluar të materialeve ekzistuese, përfshirë pllakat e vjetra, betonin dhe shtresat lidhëse, duke ruajtur integritetin e dyshemesë dhe duke grumbulluar materialet e riciklueshme sipas kërkesave të institucioneve, pasuar nga pastrimi dhe nivelimi i sipërfaqes për bazament të qëndrueshëm. Më pas përgatitet shtresa bazë me zhavorr të kompaktuar dhe rërë lidhëse ose beton të hollë, duke siguruar drenazh të duhur dhe nivelim uniform, vendosja e pllakave të gurit ekzistuese realizohet duke respektuar standardet e sigurisë dhe duke kryer ngjeshje dhe fiksime të pllakave me makineri vibruese, pasuar nga pastrimi i sipërfaqes dhe kontrolli i cilësisë së bashkimeve, nivelit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek ndërtesa e “Bibliotekës” sipas detajeve të projektit.

### **6.6 Prishje shtrese + vendosje pllaka guri fasade**

Punimet konsistojnë në prishjen e veshjes ekzistuese të fasadës dhe vendosjen e pllakave të gurit, me qëllim kryesor të mundësojnë punimet e hidroizolimit të mureve të jashtme të godinës, duke siguruar më pas rikuperimin estetik dhe funksional të sipërfaqes. Procesi fillon me heqjen e kontrolluar të pllakave ekzistuese të fasadës, duke ruajtur integritetin e strukturës së murit dhe duke grumbulluar materialet e riciklueshme sipas kërkesave të institucioneve publike, pasuar nga pastrimi i sipërfaqes dhe përgatitja e bazamentit për vendosjen e pllakave të reja. Pllakat e gurit vendosen mbi një shtresë lidhëse të përshtatshme, me përzgjedhje të kujdeshme të dimensioneve dhe ngjyrës për uniformitet estetik dhe qëndrueshmëri ndaj kushteve atmosferike, duke përdorur metoda fiksime dhe ngjeshje sipas standardeve teknike. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek ndërtesa e “Qendrës së kreativitetit” sipas detajeve të projektit.

### **6.7 Fugatim muri (Pastrim mekanik=larje me ujë+fugatime injektim)**

Punimet objekt të këtij zëri përfshijnë fugatim të murit, duke filluar me pastrim mekanik të sipërfaqes, i cili realizohet përmes larjes intensive me ujë nën presion, për të hequr pluhurin, mbetjet e materialeve të ndërtimit, grumbujt e gurëve të dëmtuar dhe depozitat e tjera të

mundshme, duke siguruar që sipërfaqja të jetë plotësisht e pastër, e lagur në mënyrë uniforme dhe e përgatitur për aplikimin e materialit të fugës. Pas pastrimit kryhet fugatim përmes injektimit, ku përdoren materiale lidhëse me përbërje hidro-izoluese ose të ngjashme me origjinalin e murit, të përshtatura sipas karakteristikave fiziko-mekanike të murit dhe llojit të pllakave të gurit, duke përfshirë ngjitës me rezistencë ndaj ujit, ndryshimeve termike dhe ngarkesave mekanike të jashtme. Injektimi realizohet në të gjitha bashkimet midis elementeve të murit me kujdes të veçantë për të siguruar mbushje të plotë, shmangie të zbrazëtirave dhe parandalim të depërtimit të ujit në strukturën e murit, duke përdorur teknika të kontrolluara që ruajnë estetikën e sipërfaqes. Procesi përfshin gjithashtu kontroll vizual dhe mekanik të çdo fuse pas tharjes, duke korrigjuar vendet me material të tepërt ose të mangët, dhe duke garantuar uniformitet dhe lidhje të plotë me elementët ekzistues. Pas përfundimit, sipërfaqja pastrohet nga mbeturinat e fugës dhe çdo mbetje e tepërt, duke ruajtur pamjen e natyrshme të gurit dhe funksionalitetin e bashkimeve. Kjo ndërhyrje do të kryhet tek ndërtesa e “Qendrës së kreativitetit” sipas detajeve të projektit.

Përgatiti - Ark. Dhimitër Këri 

Ark. Edona Venxha



Drejtori i DPPTMKI

Ark. Ndrëçim Hoxha

